



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për periudhën 6 (gjashtë) muaj dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik si dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.05/2014,për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e procedurave për Themelimin e Mardh enjës së Punës në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ nr.04/2016 për rregullimin e procedures së rekrutimit për punësimet me kontrata të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nenshtrohen Ligjit për Detyrime, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës shpallë këtë:

KONKURS

Nr.07.2018
Për angazhim të përkohshëm

Titulli i vendit të punës: Asistente Administrative një pozitë
Kategoria Funksionale: Niveli administrativo-teknik
Koeficienti: 6 (gjashtë)
Kohëzgjatja e angazhimit: Me afat të caktuar, gjashtë(6) muaj
Raporton tek: Kryetari i DHPGJS
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës

Kryerja e punëve Administrative dhe punëve të tjera në kuadër të njësisë.

Detyrat kryesore:

1. Kryerja e punëve administrative brenda zyrës sipas instruksioneve të udhëheqësit30%
2. Përcjell komplet dokumentacionin të cilin e ka pranuar dhe evidentuar(20 %);
3. Rregullishti pranon dhe dorëzon të gjitha dokumentet dhe mban evidencë të saktë lidhur me to .(20 %)
4. Mban librin e protokollit(10 %)
5. shkruan dhe përgatit raporte mbi aktivitetet e tijë10 %;
6. Kryen punë tjera sipas instruksioneve të udhëheqësit(10 %)

Shkathësitë aftësitë e kërkuara:

1. Aftësi të mira në punë ekipore.... E dëshirueshme
2. Njohuri të punës me kompjuter.....E nevojshme
3. Njohuri të mirë të gjuhës Shqipe dhe Serbe.....E nevojshme
4. Aftësi të larta komunikuese dhe shkathësi për kryerjen e punëve nën presion.... E dëshirueshme
5. 3 vite përvojë pune..... E nevojshme

Kualifikimi arsimorë dhe profesionalë për këtë post:

1. Diplomë e shkollës së mesme ----- e nevojshme.

Shënim: Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatet e jashtëm si dhe për nëpunësit civil ekzistues.

Rekrutimi dhe Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me rregullativen ligjore të cekur më lartë.

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Supreme të Kosovës-Pallati i Drejtësisë, objekti E- Lagjja "Prishtina e Re", Rr.:" Nekibe Kelmendi" pn.

[Shkarko Aplikacionin](#)

Dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet edhe përmes postes.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në tel: 038/200-17427, prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi është i hapur 3 ditë nga dita e publikimit në web-faqen zyrtare dhe tabelën e shpalljeve të Gjykatës Supreme, duke filluar nga data **14.06.2018**, deri më datën **16.06.2018**, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijn brenda 2 ditësh, aplikacionet që arrijn pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Përdorimi i aplikacionit/formularit të gabuar do të konsiderohet i pa vlefshëm.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.